



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 67

Prishtinë, më 28 Janar 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Behar Selimi, Ardian Gjini, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi, Arsim Bajrami, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivković.

Mungoi: Mufera Šinik,

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Petrit Hysaj, OSBE, Visar Smajlaj, ekspert, Behlul Zeka, EULEX, Lumnije Murati, ZPRK, Lejla Selimi, OSCE dhe Burbuqe Berisha, praktikante.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.12.2012;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04-L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari, propozoi që në pikën të ndryshme të futen edhe:

- Njoftim i Komisionit me shkresën e përfaqësuesit të unionit evropian Samuel Zhbogar, lidhur me projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Kërkesa për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për pensionet e TMK-së dërguar nga zyra për çështjet e Trashëgimisë së TMK-së;
- Njoftim i Komisionit për vizitën në Dubravë;
- Njoftim i Komisionit për mbajtjen e Punëtorisë për planin e punës së Komisionit për vitin 2013.

Behar Selimi - Propozoi që në rend dite tek të ndryshme të hynë edhe pika që ka të bëjë me strategjinë kundër korrupsionit. Ky dokument është dhe një lloj kërkesë, por më tepër është strategji kombëtare sesa politike.

Albulena Haxhiu - Tha ne si Komision e kemi përfunduar punën dhe sa i përket strategjisë, nuk mendoj se duhet të merremi prapë me këtë çështje. Në prill të vitit 2012, në seancën plenare, kjo strategji nuk ka kaluar. Është dashur që agjencia kundër korrupsion, ta përpilojë një strategji në pajtim me vërejtjet e dhëna në seancë plenare, e që këtë nuk e ka bërë.

Kryetari – Nuk kemi kompetencë që ta amendamentojmë strategjinë dhe ky dokument ose miratohet në seancë plenare ose i kthehet Qeverisë. Ky dokument tregon se si do të funksionojë agjencia kundër korrupsionit.

Armend Zemaj - Ne diskutuam dhe patëm mendime të ndryshme rreth strategjisë dhe nuk ka hapësirë për amendamentim, kurse u pajtua që të presim vendimin e seancës plenare.

Halit Krasniqi – Jam i gatshëm të mbështes çdo propozim nga Komisioni, që kjo strategji të jetë sa ma efikase.

Haki Demolli – Ne si komision tash disa herë e diskutojmë këtë strategji. Jemi deklaruar se jemi kundër kësaj strategjie, për arsye se nuk e dimë çfarë qëllimi kanë. Jemi kundër këtyre strategjive, presim rekomandimin e seancës dhe do të shohim se çka do të bëjmë.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara nga kryetari dhe nuk u miratua propozimi i deputetit Behar Selimi.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.12.2012;

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur me 24.12.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor;

Kryetari – Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, në Projektligjin për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor dhe kërkoi nga deputetet nëse kanë vërejtje për raportin.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-163, për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligji nr. 04 -L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil

Kryetari - Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, njëzëri nxori këtë

Përfundim

3. Projektligji nr. 04-L-160, për Agjencinë e Regjistrimit Civil, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
4. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Të ndryshme

- a. Njoftim i Komisionit me shkresën e përfaqësuesit të unionit evropian Samuel Zhbogar, lidhur me projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;**

Kryetari – I njoftoi me shkresën e përfaqësuesit të UE, Samuel Zhbogar, lidhur me projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, i cili ka kërkuar nga Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, që neni 3, që ka të bëjë me krime të pastrimit të parave në kompetencë ekskluzive të Prokurorisë Speciale, të mos ndryshohet, por te mbetet si në ligj. Kjo sa për njoftim sepse në këtë fazë komisioni për Legjislacion nuk mund të ndërhyjë para se ta marrim raportin me amendamente nga Komisioni FunkSIONAL.

- b. Kërkesa për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për pensionet e TMK-së dërguar nga zyra për çështjet e Trashëgimisë së TMK-së;**

Komisioni e shqyrtoi kërkesën e dërguar nga Safet Sylja, drejtor përgjithshëm i ZÇT/TMK-së, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pensionet e TMK-së dhe vlerësoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprimin e tij, andaj kërkesa si e tillë procedohet për shqyrtim të mëtejme në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, si Komision FunkSIONAL.

- c. Njoftim i Komisionit për vizitën në Dubravë;**

Kryetari - Tha se kjo vizitë është planifikuar të bëhet më 30.12.2013, mirëpo, për arsye se është caktuar mbledhja plenare të njëjtën ditë, kjo vizitë mbetet të realizohet në ditët në vijim.

- d. Njoftim i Komisionit për mbajtjen e Punëtorisë për planin e punës së Komisionit për vitin 2013;**

Kryetari – Tha se edhe kjo punëtori do të mbahet në ditët në vazhdim, për të njëjtën arsye se është caktuar mbledhja plenare.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50

Kryetari i Komisionit

E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit

Arben Gashi